



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE

Nr. 156/4 Prot.

Tiranë, më 04.03.2015

VENDIM

“ Për rrëzimin e ankesës ”

Nr 21, datë 04/03/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesja/znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 154/1 Prot., datë 18.02.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Rektoratit të Universitetit Politeknik Tiranë, me objekt “Refuzim për dhënie informacioni”, sipas së cilës pretendon se është cënuar në të drejtën për informim. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 24/1/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, z.nj Banja në datë 26.01.2015 ka paraqitur pranë Autoritetit Publik/Rektoratit të Universitetit Politeknik Tiranë, kërkesën për informacion, ku ka kërkuar të vihen në dispozicion kopje të dokumenteve, konkretisht:

1. Shkresa e zyrës së financës për ndërprerjen e pagesës.
2. Shkresa drejtuar Sigurimeve shoqërore për ndërprerjen e pagesës.
3. Shkresë për miratimin e tërheqjes së librezës së punës.
4. Kërkesa për korrigjimin e librezës së punës
5. Vënien në dispozicion të listëpagesave mujore të IGJEUM për periudhën 01.05.2013-31.12.2014.
6. Kopje të regjistrit të punonjësve.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur ankesës rezulton se, kërkesa është trajtuar brenda afatit ligjor, konform nenit 15/1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” nga Autoriteti Publik/Rektorati i Universitetit Politeknik të Tiranës.

Komisioneri pas vlerësimit të ankesës së Znj. _____, me shkresën nr. 156/1, datë 19.02.2015 kërkoi parashtrime nga Autoriteti Publik/Rektorati i Universitetit Politeknik të Tiranës të cilat duhet të vireshin në dispozicion brenda datës 23.02.2015. Duke qenë se Autoriteti Publik nuk iu përgjigj kësaj shkrese, Komisioneri me urdhrin nr.28, datë 26/02/2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Gjatë inspektimit si dhe në përgjigjen nr. 257/1 datë 26/02/2015, Autoriteti Publik/ Rektorati i Universitetit Politeknik Tiranë, ka argumentuar se shkresa e zyrës së financës për ndërprerjen e pagesës, shkresa drejtuar Sigurimeve shoqërore për ndërprerjen e pagesës dhe shkresa për miratimin e tërheqjes së librezës së punës nuk ekzistojnë. Përsa i përket kërkesës për korrigjimin e librezës së punës, Autoriteti Publik argumenton se janë tejkaluara kufijtë e të drejtave të sanksionuara në ligjin për të drejtën e informimit. Lidhur me kërkesën për listëpagesat dhe kopjen e rregjistrit të punonjësve, Autoriteti publik është shprehur se ato konsiderohen dokumente që përmbajnë të dhëna personale dhe për këtë arsye nuk mund të jepen.

Komisioneri vlerëson se kërkesat për tu pajisur me shkresën e zyrës së financës për ndërprerjen e pagesës, shkresën drejtuar Sigurimeve shoqërore për ndërprerjen e pagesës, shkresën për miratimin e tërheqjes së librezës së punës si dhe pajisja me kërkesën për korrigjimin e librezës së punës nuk janë objekt i ligjit për të drejtën e informimit për aq kohë sa një informacion i tillë nuk ekziston. Ky ligj parashikon qartë në nenin 1 të tij, të drejtën e informimit lidhur me dokumentacionin që mbahet dhe prodhohet nga Autoriteti Publik dhe nuk detyron këtë të fundit të prodhojë një informacion të ri kundrejt një kërkesë. Ndërsa lidhur me kërkesat për listëpagesat dhe kopjen e rregjistrit të punonjësve, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik është shprehur në përputhje me ligjin 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe për këtë arsye ky informacion nuk mund të jepet.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankesa rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin tërësisht të ankesës nr. 156 Prot., datë 17.02.2015 të Znj. ndaj Autoritetit Publik/ Rektoratit të Universitetit Politeknik Tiranë.

Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 04.03.2015.

